



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr.110, Datë 27.03.2023

MBI

**KËRKESËN E OST SH.A., PËR INTERVALIN KOHOR 1 ORË NË OPERIMIN E
PROCESEVE TË TREGUT BALANCUES DHE NOMINIMEVE TË
TRANSAKSIONEVE TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 576/4 prot., datë 24.03.2023 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi kërkesën e OST sh.a., për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues, dhe nominimeve të transaksioneve tregtare”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. në funksion të operimit në Tregun Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nëpërmjet shkresës nr. 756 prot., datë 03.02.2023, protokolluar e ERE me nr. 576 prot., datë 06.02.2023, ndër të tjera ka parashtruar argumentet, kushtet si dhe vlerësimet mbi implementimin e platformës së menaxhimit të tregut për intervalin kohor 1 orë ku vlerëson se nuk mund të operohet me rezolucion 15 minuta.
- Shoqëria OST sh.a., ndër të tjera deklaroi se në vijim të operimit me bazë orare për llogaritjen e disbalancave, për proceset në tregun balancues dhe për proceset e nominimit, ka bërë reflektimet e saj duke i përcjellë si draft propozime të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit. Gjithashtu në vijim të zhvillimeve rajonale, OST sh.a. shprehet se ka infrastrukturën e nevojshme për të vepruar si vendet e rajonit për sa i përket tregut balancues.

- Në zbatim të urdhrit nr. 33, datë 24.02.2023, ERE, organizoi një seancë dëgjimore, mes përfaqësuesve të shoqërisë OST sh.a., Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), dhe Albanian Power Exchange (ALPEX) sh.a. për të diskutuar lidhur me kooperimin e platformës së menaxhimit të tregut me platformën e Bursës Shqiptare të Energjisë e cila është me rezolucion orar, duke marre në konsideratë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.
- OST sh.a., përgjatë periudhës kohore nga 1 Prill 2021, momenti kur ka filluar operimi i tregut të balancimit të energjisë elektrike bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106/2020, nuk ka aplikuar rezolucionin 15 minutësh, si periudhë kohore e proceseve ku përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave, por intervalin kohor prej 1 orë.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 108, datë 22.04.2021, ka miratuar “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”. Këto rregulla aplikohen nga OST-të e Evropës kontinentale, anëtare të ENTSO - E, që nga data 1 Qershor 2021. Aktualisht për OST sh.a., aplikimi i këtyre rregullave është duke u realizuar me intervalin kohor prej 1 ore. Në këtë kontekst aplikimi i intervalit kohor prej 1 ore në tregun e brendshëm të balancimit të energjisë elektrike nuk sjell asnjë pasojë për këtë mekanizëm, përkundrazi aplikimi i afatit kohor prej 1 ore edhe në tregun e brendshëm të balancimit ndikon në harmonizimin e këtyre proceseve.
- Vlerësimi i dhënë nga AAES, e cila e konsideron si pozitiv funksionimin e tregut shqiptar të balancimit në rezolucionin 15 minutësh, pasi kontribuon në qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik është një vlerësim i saktë dhe adreson në mënyrë të drejtë këtë çështje.
- Duke qenë se për periudhën në vijim të vitit 2023, ALPEX sh.a. pritet të fillojë operimin komercial të tregut të energjisë elektrike, gjykojmë të arsyeshme pranimin e pjesshëm të kërkesës së OST sh.a. Për periudhën 1 Prill 2023 deri 1 Prill 2024, pra për një vit të operohet në tregun e balancimit të energjisë elektrike me intervalin kohor prej 1 ore. Gjatë kësaj periudhe kohore 1 vjeçare do të mund të vlerësohet ecuria e operimit të tregut që do të operohet nga ALPEX sh.a. dhe tregut të balancimit që operohet nga OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së OST sh.a., “Periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore, për periudhën 1 Prill 2023 deri në 1 Prill 2024.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

